



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra për Komunikim me Publikun
Kancelarija za Javno Komuniciranje
Office of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesat Direkte për prodhimin e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit të prodhuara mbi nënshartesa vegjetative

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të mbështes fermerët prodhues të materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhise të rrushit mbi nënshartesa vegjetative përmes pagesave direkte. Subvencionimi (pagesa direkte) do të bëhet për fidanë të prodhuar.

Fermerët që aplikojnë duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Duhet të posedoj minimum 0.50 ha toke bujqësore (në pronësi të tyre ose të marrur me qira);
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për 2 (dy) vite;
- Fermeri duhet të ketë prodhuar gjatë vitit kalendarik 2014 minimum **5000** fidane dhe në maksimum **100,000** fidane të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative;

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të subjektit;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatën mbi biznesin;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshminë – vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK;
- Kopjen e Licencës së MBPZHR për prodhimin e materialit fidanor të pemëve;
- Kopjen e Licencës së MBPZHR për prodhimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit;

- Kopjen e deklarimit të sasisë së prodhuar të fidanëve për vitin kalendarik 2014 të vërtetuar nga Inspektori Fitosanitar (ky dokument merret në DPBT-MBPZHR);
- Kopjen e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të fidanëve të prodhuar (ky dokument silllet pas bërjes së analizave të fidanëve për gjendjen shëndetësore);
- Dëshminë – procesverbalin nga Inspektori Fitosanitar për posedimin e pemishtës amë të nënshartësave vegetative;
- Dëshminë – procesverbalin nga Inspektori Fitosanitar për posedimin e vreshtit amë të nënshartësave vegetative;
- Për nënshartesat vegetative të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit të sjellura nga importi, fermeri duhet të posedojë këtë dokumentacione: certifikatën fitosanitare për gjendjen shëndetësore të nënshartësave vegetative të lëshuar nga vendi-shteti prej të cilit janë importuar nënshartesat vegetative dhe dokumentin unik doganor (DUD) që dëshmon se nënshartesat janë futur në Kosovë në mënyrë të rregullt përmes doganës;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve – qiradhënësit dhe qiramarrësit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për fidan;
- Subvencionimi do të bëhet vetëm për fidanet njëvjeçare;
- Perfitues do të jenë fermeret të cilët gjatë vitit 2014 prodhojnë mbi 5000 fidane të pemëve drufrutore ose hardhise të rrushit mbi nënshartesa vegetative;
- Fermeret që prodhojnë minimum 5000 deri në 25000 fidane të pemëve drufrutore mbi nënshartesa vegetative do të subvencionohen në vlerë prej 0.20 €/fidan;
- Fermeret që prodhojnë mbi 25000 deri 50000 fidane të pemëve drufrutore mbi nënshartesa vegetative do të subvencionohen në vlerë prej 0.15 €/fidan;
- Fermeret që prodhojnë mbi 50000 deri 100000 fidane të pemëve drufrutore mbi nënshartesa vegetative do të subvencionohen në vlerë prej 0.10 €/fidan;
- Fermeret që prodhojnë minimum 5000 deri në maksimum 100000 fidane të hardhise të rrushit do të subvencionohen në vlerë prej 0.10 €/fidan;

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 30 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike.

Aplikimi bëhet në zyret e Drejtorive Komunale për Bujqësi.

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë fermerët fillimisht, gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve (vlen vetëm për fermerët të cilët nuk janë regjistruar në regjistrin e fermës deri në momentin e aplikimit), i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.

Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në nenin 31 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2014 për pagesat direkte në lëmin e bujqësisë.

Sqarim:

Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.